

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Punëve të Brendshme**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	214-25-4909-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit me titull: "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - II"

ANKESË

Emri i plotë i kompanisë:

AVAG GROUP-H&S PARTNERS
GROUP SHPK

Adresa:

Rruga Mbreti Genc

Vendi:

Prishtinë

Kodi postar:

10000

Numri Telefonit:

049 461 460

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:

Muhamet Aliu

Adresa elektronike:

groupavag@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës

04 maj, 2026

Nënshkrimi dhe vula:



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit: Bert Geci

Adresa e plotë: Rruga Avdullah Tahiri nr. 105, Gjilan

Numri i telefonit: 045 518 181

Data e parashtrimit të ankesës: 04 maj 2026

Nënshkrimi dhe vula:



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Data	Përshkrimi i kronologjisë procedurale të aktivitetit
05.06.2025	Publikimi i Njoftimit për Kontratë - procedurë e hapur, 6 lote, vlera totale 1,320,000 € Vlera totale e parashikuar: 1,320,000 € Kriteri për dhënie: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
15.07.2025	Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve
13.08.2025	Njoftim mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde (shpallet fitues OE EJONA SHPK)
18.08.2025	Parashtrimi i Kërkesës për Rishqyrtim nga AVAG GROUP pranë AK-MPB
26.08.2025	Vendimi i AK për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, lihet në fuqi vendimi i AK
04.09.2025	Parashtrimi i Ankesës nga AVAG GROUP pranë OSHP-së
27.10.2025	Vendimi OSHP nr. 2025/0850: anulim i vendimit të AK; kthim i lëndës në rivlerësim

27.11.2025	Njoftim mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde (rishpallet fitues OE EJONA SHPK)
02.12.2025	Parashtrimi i Kërkesës për Rishqyrtim nga AVAG GROUP pranë AK-MPB
09.12.2025	Vendimi i AK per refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, lihet ne fuqi te vendimit te AK
18.12.2025	Parashtrimi i Ankesës nga AVAG GROUP pranë OSHP-së
05.02.2026	Vendimi OSHP nr. 2025/1239: anulim i vendimit të AK; kthim i lëndës në rivlerësim
06.03.2026	Njoftim mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde (shpallet fitues OE AVAG GROUP)
11.03.2026	Parashtrimi i Kërkesës për Rishqyrtim nga OE EJONA SHPK pranë AK-MPB
17.03.2026	Parashtrimi i Kërkesës për Hedhje si te Palejuar të Kërkesës Rishqyrtim të OE EJONA
17.03.2026	Vendimi i AK per aprovimin e Kerkeses per Rishqyrtim te OE EJONA, kthimi i lëndës në rivlerësim
15.04.2026	Paraqitja e kërkesës pranë AK për anulimin dhe shfuqizimin e vendimit dt.17.03.2026
16.04.2026	Njoftim mbi Vendimin e AK per anulimin e aktivitetit te prokurimit
21.04.2026	Parashtrimi i Kerkeses per Rishqyrtim nga AVAG GROUP pranë AK - MPB
24.04.2026	Vendimi per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim
04.05.2026	Ankesa pranë OSHP

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi i hapjes se tendereve behet pa pranine e OE pjesemarrres

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po



Jo



Më datë 15.04.2026, kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, kurse AK -MPB me vendimin e datës 24.04.2026, e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Parashtruesi konsideron se akti i kontestuar për anulimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vendimet që e kanë paraprirë dhe shkaktuar atë, duke përfshirë edhe vendimin e datës 17.03.2026 për kthimin e lëndës në rivlerësim si rrjedhojë e pranimit të kërkesës të OE EJONA SHPK, e cila ligjërisht nuk e ka statusin e palës me interes material, janë nxjerrë në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe në mënyrë të paligjshme sipas dy vendimeve detyruese të OSHP dhe dispozitave të mëposhtme:

LPP Nr. 04/L-041 (Versioni i Konsoliduar) dhe RRPP Nr. 02/2024 (Versioni i Konsoliduar)

- Nenin 62 i LPP i lidhur me nenin 43 paragrafi 5 i RRPP
- Nenin 9 ne paragrafin 5 te LPP lidhur me nenin 8 te RRPP

si tërësi me dispozitat

- Nenin 1 në paragrafin 2 dhe 3 i LPP lidhur me nenin 4.3 i RRPP;
- Nenin 6 në paragrafin 1 lidhur me nenin 4.3 ne pikat c, f, g të RRPP;
- Neni 24 në paragrafin 2 të LPP
- Nenin 7 në paragrafin 1, 2, 4 i LPP lidhur me nenin 4.3 ne pikat c, f, g të RRPP;
- Nenin 59 në paragrafin 4 të LPP lidhur me nenin 40 ne par. 1, 2.1, 6 të RRPP
- Nenin 60 në paragrafin 1.1 të LPP lidhur me nenin 40 ne paragrafin 13 te RRPP;
- Nenin 103 lidhur me nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafi 26 te LPP
- Nenin 105 në paragrafin 2.16 të LPP lidhur me nenin 67.9 te RRPP

Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e RKS për Vitin 2026

- Tabelën 3.2 - Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, Kodi buxhetor 12992, kolona nr. 5 "Renovimi i Objekteve Qeveritare".

Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative:

- Nenin 54 në paragrafin 1.2 te LPPA;
- Neni 55 ne paragrafin 1 te LPPA.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtrore.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Rrethanat procedurale të aktivitetit në fjalë.

- Me 05.06.2025, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar në procedurë të hapur dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI", me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, me vlerë të parashikuar për 6 lote prej 1,320,000.00€
- Parashtruesi i kërkesës, Avag Group Sh.p.k. & H&S Partners Group Sh.p.k., ka marrë pjesë duke ofertuar për LOT I me çmim total 239,760.00€ dhe LOT II me çmim total 239,400.00€, duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit. Për Lot II, gjithashtu kishte ofertuar edhe OE "EJONA SH.P.K."
- Gjatë tërë ciklit të prokurimit për LOT II, AK përmes vendimeve të datave 13.08.2025 dhe 27.11.2025 e kishte diskualifikuar ofertën e parashtruesit dhe e kishte shpërblyer me kontratë OE EJONA SHPK, ndonëse ky operator ishte shpallur i papërgjegjshëm me vendim të formës së prerë nga OSHP
- Lidhur me këto vendime, parashtruesi ka ushtruar dy herë ankesë në OSHP. Përmes vendimeve nr. OSHP:2025/0850, datë 27.10.2025 dhe OSHP:2025/1239, datë 05.02.2026, OSHP i ka aprovuar në tërësi ankesat, duke anuluar vendimet e AK si të kundërligjshme, duke konstatuar ofertën e OE EJONA SHPK si të papërgjegjshme dhe duke e kthyer lëndën në rivlerësim për të korrigjuar parregullsitë ligjore në përputhje me kërkesat ligjore.
- Me datë 06.03.2026, në zbatim të vendimeve të OSHP-së, dhe se duke vlerësuar se oferta jonë i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, AK e ka shpallur fitues të LOT II ofertën e Avag Group Sh.p.k. & H&S Partners Group Sh.p.k.
- Me datë 11.03.2026, OE EJONA SHPK, në dijeni të statusit të saj si tender i papërgjegjshëm i konfirmuar me dy vendime të OSHP-së, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-MPB. Duke qenë se OE EJONA SHPK nuk e gëzon statusin e palës me interes material sipas nenit 4.1.26 lidhur me nenin 103 të LPP-së, kemi kërkuar nga AK që kërkesa e saj të hidhet poshtë si e palejuar.
- Përkundër kësaj, me datë 17.03.2026, AK e ka pranuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE EJONA SHPK dhe e ka anuluar vendimin e saj për dhënien e kontratës, duke e kthyer lëndën në rivlerësim.
- Me datë 16.04.2026, ZPP i AK-së, në kundërshtim me çdo standard/praktikë ligjore ka nxjerrë vendim me të cilin e ka anuluar aktivitetin e prokurimit për LOT II, me arsyetimin se MPB nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore, duke u thirrur në rrethana të paparashikueshme lidhur me riorganizimin institucional të kryer me Vendimin e Qeverisë nr. 02/02, datë 20.02.2026, me të cilin është bërë ndarja e ministrisë dhe krijimi i strukturave të reja institucionale.
- Për këto arsye, duke u mbështetur në procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve më datë 21.04.2026 parashtruesi i është drejtuar AK - Ministrisë së Punëve të Brendshme,

me kërkesë për rishqyrtim, me qëllim që të ndalet këtu kjo paligjshmëri e qëllimshme dhe të anulohet vendimi në fjalë, në mënyrë ankuesit t'i garantohet e drejta e fituar mbi bazën ligjore, në përputhje me vendimin e AK-MPB të datës 06.04.2026, dy vendimet përfundimtare të OSHP, si dhe në përputhje me dispozitat relevante të LPP, RRPP, UPP dhe kufijtë e përcaktuar ligjor sipas Kodit Etik për të cilat jeni deklaruar nën betim.

- Megjithatë, ZPP i AK, me vendimin e nxjerrë më datë 24.04.2026, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar, me arsyetimin e njejtë sikurse në vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Arsyetimi i vendimit të kundërshtuar nuk mbështetet në fakte, prova dhe dispozita ligjore konkrete që përcaktojnë kriteret e anulimit të një aktiviteti të porokurimit dhe rastet e fuqisë prapaveruese të akteve administrative, siç e kërkon detyrimi ligjor bazuar në parimin e ligjshmërisë. Krahas kësaj, nga arsyetimi i vendimit të kundërshtuar shihet se përgjigjet e AK janë të përgjithshme dhe kundërthënëse, pa i trajtuar në mënyrë meritore të gjitha pretendimet ankimore dhe faktet dhe provat e paraqitura konform gjendjes faktike dhe bazës ligjore
- Për këto arsye, me anë të kësaj ankese i drejtohem OSHP-së, me qëllim mbrojtjen e të drejtës sonë ligjore, e cila mund të garantohet përmes një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm nga ana e institucionit tuaj, në përputhje me nenin 104, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP-së.

2. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi i parë Kundërshtimin e vendimit të AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të GOE " AVAG GROUP SH.P.K., si vendim i pabazuar në fakte dhe në dispozita ligjore.

- Autoriteti Kontraktues, me vendimin e nxjerrë më datë 24.04.2026, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga GOE "Avag Group – H&S Partners Group" SH.P.K. Vendimi është nxjerrë pa dhënë asnjë arsyetim të argumentuar dhe të mbështetur në fakte apo në dispozitat përkatëse ligjore në lidhje me pretendimet e paraqitura.
- Vendimi bie ndesh me detyrimet e qarta ligjore të Autoritetit Kontraktues, nga neni 108/A paragrafi 12 të LPP-së, i cili kërkon shprehimisht që konstatimet e parashtuara të jenë të analizyara dhe arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme dhe konform gjendjes faktike dhe bazës ligjore në raport me pretendimet ankimore dhe faktet dhe provat e paraqitura nga pale. Gjithashtu bie ndesh me nenin 24 paragrafi 1 të LPP, dispozitë kjo e cila e obligon AK që të gjitha aktivitetet e prokurimit të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.
- Në rastin konkret, ZPP i AK nuk ka përmbushur asnjërin nga këto standarde. Në vend që të analizojë pretendimet dhe faktet e paraqitura nga ankuesi në raport me gjendjen faktike dhe ligjore – siç e kërkon neni 1, 7, 24 dhe 62 i LPP – është mjaftuar me pohime të përgjithshme dhe me referenca ndaj dy vendimeve të Qeverisë të datave 20.02.2026 dhe 19.03.2026, duke pretenduar se veprimet e AK janë në përputhje me dispozitat procedurale të prokurimit. Megjithatë, këtë qëndrim nuk e ka mbështetur me asnjë fakt apo argument konkret. Konkretisht, ZPP i AK nuk e ka shpjeguar dhe vërtetuar me asnjë fakt dhe prove konkrete në aspektin faktik dhe juridike, çështjet themelore si vijon:

- **E para:** Cila dispozitë ligjore konkrete lejon dhe i jep fuqi prapavepruese vendimeve të Qeverisë të datave 20.02.2026 dhe 19.03.2026, në mënyrë të tillë që ato të përdoren në dëm të të drejtave të fituara të GOE ankues?
Sipas Ligjit për Procedurën Administrative dhe Komentarit të tij, akti administrativ mund të ketë fuqi prapavepruese vetëm në rastete meposhtme: a) *kur vetë ligji e parashikon shprehimisht;* b) *kur fuqia prapavepruese është në favor të palës së interesuar dhe nuk i dëmton të drejtat e saj;* dhe c) *kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor me të cilin një akt i mëparshëm është deklaruar i pavlefshëm.* Në rastin konkret nuk ekziston asnjëra prej këtyre situatave. Prandaj, përdorimi i këtyre vendimeve me efekt prapaveprues për të cenuar të drejtat e GOE ankues nuk ka kurrfarë baze ligjore dhe bie drejtpërdrejt ndesh me parimin e ligjshmërisë.
- **E dyta:** Është tërësisht e paarsyetuar arsyeja pse AK i ka zbatuar këto vendime në mënyrë selektive dhe ekskluzivisht ndaj GOE ankues, duke i shpërfillur në raport me OE tjetër për LOT I në të njëjtat kushte. Fakti është konkret, me Vendimin e datës 06.03.2026, i cili ka ardhur plot 21 ditë pas Vendimit të Qeverisë të datës 20.02.2026, në të cilin AK tani thirret si pengesë për realizimin e aktivitetit të prokurimit për LOT II dhe anulimin e tij, AK ka shpërblyer OE tjetër "Lurn Sh.p.k. me dhënie të kontratës dhe e ka nënshkruar atë kontratë me datë 13.03.2026.

Provë 1: Shih vendimin për dhënie e dt 06.03.2026 dhe Kontraten e dt.13.03.2026

Prandaj, nëse ai vendim qeveritar pengonte vazhdimin e procedurës për mungesë mjjetesh, atëherë e njëjta pengesë ekzistonte edhe për LOT I në të njëjtën kohë. Ky trajtim i dyfishtë dhe selektiv, pa asnjë shpjegim juridik, nuk është gabim procedural i rastit, është shkelje e hapur e parimit të barazisë së trajtimit dhe e parimit të sigurisë juridike, të cilat garantojnë që të gjitha palët e interesuara mbahen ndaj të njëjtave rregulla, pa përjashtime dhe pa dallime të pajustificuara. Një veprim i tillë tendencioz dhe jokonsistent i AK jo vetëm që bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, por njëkohësisht krijon jostabilitet në marrëdhëniet juridike, cenon garancitë juridike dhe pritet legjitime të GOE ankues, që mbrohen shprehimisht nga legjislacioni në fuqi dhe që organet e prokurimit janë të detyruara t'i respektojnë në çdo fazë të procesit.

- **E treta:** Përveç tjerash, ZPP i AK nuk ka shpjeguar me asnjë fakt apo provë konkrete se si është e mundur që pas kthimit të aktivitetit në rivlerësim të merret vendim, qoftë refuzim, aprovim apo anulim duke e anashkuar tërësisht procedurën e rivlerësimit nga komisioni përkatës dhe pa nxjerrë raportin e rivlerësimit. Kjo është shkelje e hapur e procedurës dhe nenit 39 të RRPP, pasi vendimi i tillë nuk ka bazë procedurale dhe mbetet i pambështetur faktikisht dhe juridikisht.
 Krahas kësaj, ZPP i AK nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë konkrete për të shpjeguar interpretimin e tij në lidhje me statusin e palës me interes lidhur me OE EJONA SHPK, i cili ndryshon në mënyrë të plotë me gjendjen faktike të vërtetuar nga vetë AK me Vendimin e datës 06.03.2026, si dhe me dy vendimet e OSHP-së dhe me bazën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 4.126 të LPP të lidhur me nenin 108/A dhe 103 të LPP

- Gjithashtu ZPP i AK mundohet që ta ngatërrojë përshkrimin e gjendjes faktike kur kontaton se këto mjete kanë egzistuar siç pretendon ankuesi mirëpo duke ju referuar vendimit të 19.03.2026 thekson që ndarja buxhetore ka ndryshuar, gjë që nuk qëndron e sakëtë, për shkakun se sipas Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e RKS për Vitin 2026, buxheti i njejtë në vlerën totale 2.9 milion euro figuron në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Tabelën 3.2 - Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, Kodi buxhetor 12992, kolona nr. 5 "Renovimi i Objekteve Qeveritare"
- Për më tepër, ZPP i AK po i referohet transferimit buxhetor në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 30 paragrafi 3 i këtij ligji parashikon se transferimi me vendim të Qeverisë mund të bëhet vetëm për shumë që tejkalon 15% por që mbetet nën 25% të ndarjes buxhetore të ndikuar. Ndërsa neni 30 paragrafi 4 është edhe më i qartë — për çdo transferim të barabartë me 25% ose më shumë, Ministri mund ta autorizojë atë vetëm pasi të ketë marrë miratimin me shkrim nga Kuvendi. Në rastin konkret bëhet fjalë për transferim të plotë — 100% të vlerës pa miratimin e Kuvendit, siç e kërkon shprehimisht ligji. Prandaj, referimi i AK ndaj këtij transferimi si bazë për anulimin e aktivitetit nuk ka mbështetje ligjore.

Për këto arsye, konsiderojmë se vendimi i AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk përmbush standardet ligjore të arsyetimit dhe është vendosur në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RRPP-së, si dhe me parimet bazike të procedurës administrative. Si i tillë, ai duhet të shpallet i paligjshëm. Andaj kërkojmë që OSHP-ja të konstatojë këtë shkelje ligjore

Ju lutem shihni vendimi i AK per refuzim te kerkeses per rishqyrtim

Në vijim paraqiten pretendimet ankimore të parashtruara pranë AK nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim të datës 21.04.2026, të cilat mbështeten në fakte konkrete dhe analiza ligjore që dëshmojnë shkelje të dispozitave përkatëse të LPP-së dhe akteve nënligjore në fuqi.

Pretendimi i dytë (Pretendimi i parë i Kërkesës për Rishqyrtim)

1. Autoriteti Kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme, përmes vendimit të saj (B58), të datës 16.04.2026, ka vendosur që të anulojë aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - II", nr. Prok. 214-25-4909-2-1-1. Sipas vendimit të kundërshtuar me këtë kërkesë për rishqyrtim, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK-MPB, pretendon se këtë vendim e ka marrë pasi që MPB nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore, duke u thirrur në rrethana të paparashikueshme lidhur me riorganizimin institucional të kryer me Vendimin e Qeverisë nr. 02/02, datë 20.02.2026, me të cilin është bërë ndarja e ministrisë dhe krijimi i strukturave të reja institucionale.
2. Duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe dispozitat e nenit 62 lidhur me nenin 9 të LPP dhe nenit 43 të RRPP, të cilat përcaktojnë shprehimisht rastet kur AK mund të ndërpresë një procedurë prokurimi, vërtetohet se arsyeja në të cilën është thirrur

ZPP nuk gjen zbatim në asnjërën nga këto dispozita. Mirëpo, vendimi për anulimin e LOT II, në ndërlidhje të vendimeve paraprake², është i motivuar nga interesa të tjera përtej atyre ligjore, me qëllim të vetëm zhvleftësimin e vendimit të datës 06.03.2026 dhe parandalimin e nënshkrimit të kontratës, duke qenë se OE konkurrese EJONA SHPK e preferuar nga AK nuk ka mundur në asnjë rrethanë të shpërblehet me kontratë.

3. Tendencioziteti i tij rezulton nga vijimësia e një skeme të planifikuar për të zhveshur parashtruesin nga e drejta e fituar ligjrisht. Anulimi i aktivitetit është përfundim i paracaktuar, të cilit i janë paraprirë tre hapa të njëpasnjëshëm: vendimi i datës 06.03.2026 për dhënie të kontratës, i cili shërbeu si maskim i zbatimit formal të vendimeve të OSHP-së për të shmangur çdo përgjegjësi procedurale dhe për të krijuar justifikimin e nevojshëm për hapat pasues; vendimi i datës 17.03.2026 me të cilin është pranuar kërkesa e OE të papërgjegjshëm si e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim, si mjet për ta zhvleftësuar vendimin për dhënie të kontratës të datës 06.03.2026 duke krijuar pamjen e procesit të rregullt ligjor; dhe vendimi i datës 16.04.2026 për anulimin e plotë të aktivitetit, si hallka përmbyllëse e kësaj skeme, me të vetmin qëllim parandalimin e nënshkrimit të kontratës me parashtruesin si fitues legjitim. Kjo skemë konfirmohet nga fakti se me të njëjtin vendim të OSHP (OSHP:2025/1239) të datës 05.02.2026, është konfirmuar fituesi edhe për LOT I, kontratë e cila është nënshkruar dhe po ekzekutohet normalisht, duke dëshmuar se anulimi i LOT II nuk është rezultat i rrethanave objektive dhe ligjore, por i kësaj skeme të planifikuar. Ashtu që objekt i realizimit të kësaj kontrate, përveq objekteve të MPB, shumica e objekteve tjera janë të institucioneve apo agjencioneve tjera publike (IKAP Rr. Nekibe Kelmendi p.n. Lagja Hajvali, Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (pranë IKAP-it) - Lagja Hajvali; Inspektorati i Punes (përballë Restorant Pishat) Lagja Qendër; ish Adminiatrata Tatimore e Kosovës, bordi i ATK-së Rr. Lidhja e Pejës (te Santeja); Agjencioni për Punësim dhe Aneksi i MFPT - përballë ish Fazitës)
4. Në mënyrë më specifike, pretendimet e paraqitura nga ZPP në vendimin e kontestuar si pretekst për anulimin e aktivitetit për LOT II janë të kundërligjshme, pasi bien ndesh me kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 62 lidhur me nenin 9 të LPP dhe neni 43 i RRPP. Po ashtu bien ndesh në dhe ndërlidhje me dispozitat e nenit 1 par.2 dhe 3, nenit 7 par. 1,2,4 te LPP lidhur me ne nenin 4.3 pikat c,f, g te RRPP, nenit 24 par. 2 te LPP, nenit 59 par.4 dhe nenit 60 par.1.1 te LPP lidhur me nenin 40 par. 1, 2.1, 6 dhe 13 te RRPP, nenit 105 par.2.16 të LPP lidhur me nenin 67.9 te RRPP. Krejt këto, bazuar në faktet dhe argumentet konkrete që do t'i radhisim si në vijim:

Së pari, thirrja e ZPP-së në rrethana të paparashikueshme lidhur me riorganizimin institucional të kryer me Vendimin e Qeverisë nr. 02/02, datë 20.02.2026, bie ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe ndalimin e efektit prapaveprues (retroaktiv). Ngase, të gjitha aktet dhe veprimet e ndërmarra nga organet shtetërore që ushtrojnë autorizime publike, përfshirë procedurën për përcaktimin e një detyrimi apo

² Njoftim mbi Vendimin e AK i dt. 13.08.2025 per dhënien e kontratës OE EJONA SH.P.K.
Njoftim mbi Vendimin e AK i dt. 27.11.2025 per dhënien e kontratës OE EJONA SH.P.K.
Vendimi i dt. 17.03.2026 per aprovimin e kërkesës per rishqyrtim te OE EJONA SHPK

njohjen e një të drejte, duhet të zhvillohen në përputhje me ligjin në fuqi në momentin e ndërmarrjes së tyre, dhe aktet kanë efekt nga dita e miratimit të tyre. Andaj, marrëdhëniet juridike të filluara dhe zhvilluara sipas ligjit në fuqi nuk mund të ndryshohen retroaktivisht përmes justifikimit të një akti të mëvonshëm, por përfundojnë në bazë të ligjit në fuqi. Vendimi i Qeverisë është akt i përgjithshëm administrativ që rregullon organizimin institucional, nuk mund të prodhojë efekte juridike në mënyrë retroaktive, nuk mund të zëvendësojë dhe nuk ka fuqi të derogojë nga legjislacioni special (lex specialis) i prokurimit, LPP i plotësuar me aktet nenligjore, RRPP dhe UPP. Dhe si i tillë nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për anulimin e një aktiviteti prokurimi, i cili është nisur dhe zhvilluar para këtij vendimi, dhe që rregullohet në mënyrë shprehimore nga neni 62 lidhur i LPP dhe neni 43 i RRPP. Andaj, anulimi i aktivitetit duke u thirrur në këtë arsyetim, bie ndesh me konceptin e sigurisë juridike dhe me këto dispozita dhe nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik legjitim.

Së dyti, pretendimi i AK-MPB se nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure prokurimi nuk qëndron i bazuar, pasi bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me gjendjen faktike dhe me dispozitat e LPP-së që rregullojnë iniciimin e aktiviteteve të prokurimit. Neni 9 i LPP-së kërkon që, para çdo aktiviteti prokurimi, ZKA dhe ZKF të përgatisin dhe nënshkruajnë "*Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve*", e cila konfirmon se fondet janë në dispozicion në shumën të mjaftueshme për realizimin e kontratës, duke u mbështetur në ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, të konfirmuara në tabelat e Ligjit për Ndarjet Buxhetore. Kjo deklaratë është nënshkruar nga vetë ZPP, ZKF dhe ZKA më datë 13.08.2025 dhe është pjesë e dosjes së tenderit që konfirmon se fondet janë në dispozicion në shumën të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Gjithashtu, Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, i publikuar në Gazetën Zyrtare më 02.03.2026 - pas riorganizimit të pretenduar, parasheh shprehimisht ndarje të mjaftueshme buxhetore në kuadër të Organizatës Buxhetore: **Ministria e Punëve të Brendshme (Kodi 214000)**, konkretisht në Tabelën 3.2 - Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, Kodi buxhetor 12992, kolona nr. 5 "*Renovimi i Objekteve Qeveritare*".

Prove: Ju lutem Deklaratën e disponueshmërisë së fondeve dhe tabelën me ndarjet buxhetore.

Prandaj, pretendimi për mungesë fondesh bie në kundërshtim me deklaratën e nënshkruar sipas nenit 9 të LPP-së dhe me buxhetin e planifikuar e të miratuar për vitin 2026, duke e bërë këtë arsyetim juridikisht të paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së.

Së treti, dhe më e rëndësishmja, pretendimi i AK-MPB se ky anulim bëhet në përputhje me dispozitat e LPP dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike nuk qëndron, pasi bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me gjendjen faktike të konstatuar melartë dhe me kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 62 i LPP lidhur me nenin 43 të RRPP. Neni 62 i LPP përcakton shumë qartë se anulimi lejohet vetëm kur "*një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh... e cila nuk mund të rregullohet*" dhe

kur "të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmim që e tejkalon buxhetin", ndërsa neni 43 i RRPP përcakton në 11 pika rastet pas hapjes së ofertave kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës. Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë shkelje e tillë dhe oferta jonë është brenda kufijve buxhetorë të vlerës së parashikuar për LOT II, ndërkohë që procedura për dhënien e kontratës sipas vendimit të datës 06.03.2026 është realizuar në përputhje të plotë me dy vendimet detyruese të OSHP-së. Anulimi selektiv vetëm për LOT II, nuk gjen zbatim në asnjërën nga rastet e listuara dhe përmban mungesë absolute të bazës ligjore, duke e bërë këtë akt arbitrar dhe të pavlefshëm, pasi objekti i tij është ligjërisht i pamundur. Në thelb, anulimi selektiv për LOT II është prova më e qartë e motivimit të kundërligjshëm me qëllim parandalimin e nënshkrimit të kontratës me parashtruesin si fitues legjitim sipas vendimit të datës 06.03.2026, në zbatim të vendimeve të OSHP-së. Kështu që, përveç tjerash, veprimet e AK-së me marrjen e aktit të tillë, dhe zvarritja e planifikuar për këtë lot duke qenë se kjo çështje është gjykuar dy herë nga OSHP me vendime të formës së prerë, bien në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së, i cili kërkon që vendimet e zyrtarëve publik të mos ndikohen nga interesa personale dhe të karakterizohen me jodiskriminim, transparencë dhe përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të ligjit.

Andaj, duke u bazuar në gjendjen faktike dhe juridike të paraqitur më sipër, konsiderojmë se me marrjen e vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit për LOT II, ZPP ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, lidhur me nenin 43 të RRPP-së, si dhe njëkohësisht edhe në kundërshtim me nenet 1, 7, 24, 59, 60 dhe 105 të LPP-së, në ndërlidhje me nenet 4.3 pika (c), (f), (g), si dhe nenin 40 paragrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, paragrafët 6 dhe 13, si dhe nenin 43 të RRPP-së.

Së katërti, vendimi për anulimin e aktivitetit për LOT II është nxjerrë edhe me shkelje flagrante të detyrimeve procedurale të parashikuara nga neni 59.1 i LPP lidhur me nenin 39 të RRPP dhe nenin 40.2.1 të Rregullores nr. 002/2024, të cilat përcaktojnë se AK është e detyruar të themelojë Komision Vlerësues për ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave, përfshirë rastet kur aktiviteti kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë për rishqyrtim apo vendimi të OSHP-së. Me vendimin e datës 17.03.2026, i njëjti ZPP e ka kthyer lëndën në rivlerësim, por nuk ka themeluar fare Komision Vlerësues dhe nuk ka hartuar raport vlerësimi, duke shkelur kështu detyrimet e tij ligjore në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme. Kjo konfirmohet nga vetë ZPP-ja, i cili në përgjigjen elektronike të datës 20.04.2026, në lidhje me kërkesën e parashtruesit për qasje në raportin e komisionit të rivlerësimit, ka konfirmuar se komisioni nuk është themeluar fare dhe rrjedhimisht nuk ekziston asnjë raport. Kjo përgjigje e AK-së është dëshmi vetëinkriminuese, se ZPP-ja ka qenë i vetëdijshëm se vendimi për anulim të aktivitetit, përfshirë edhe vendimin e datës 17.03.2026 ishte i kundërligjshëm dhe se rivlerësimi nuk do të

kryhej kurrë, duke konfirmuar kështu se pranimi i kërkesës së OE të papërgjegjshëm dhe kthimi i lëndës në rivlerësim kanë shërbyer si pretekst për të arritur tek anulimi i aktivitetit, me qëllim të vetëm parandalimin e nënshkrimit të kontratës me parashtruesin si fitues legjitim.

Pretendimi i tretë (Pretendimi i dytë i Kërkesës për Rishqyrtim)

Me qëllim të pasqyrimin kronologjik të plotë të gjendjes faktike dhe të veprimeve të ndërlidhura të kundërligjshme të AK-MPB gjatë administrimit të këtij procesi, përmes këtij pretendimi prezentojmë faktet dhe provat konkrete lidhur me vendimin e datës 17.03.2026, me të cilin ZPP, në shkelje të vendimeve detyruese të OSHP-së dhe të parimit "*res judicata*", ka pranuar e ka kthyer lëndën në rivlerësim pa asnjë bazë ligjore kontestuese, duke pranuar si të bazuar kërkesën e OE EJONA SHPK, e cila sipas vendimeve të formës së prerë të OSHP nuk e gëzon statusin e palës me interes material sipas nenit 4.1.26 lidhur me nenin 103 të LPP-së.

Kjo si rrjedhojë ka sjell situatën juridike që ZPP të vazhdojë pastaj me shkelje tjera ligjore nga skema e planifikuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lart, duke anuluar aktivitetin e prokurimit, me të vetmin qëllim parandalimin e nënshkrimit të kontratës me parashtruesin si fitues legjitim.

Faktet dhe provat konkrete:

Së pari, me aktvendimin e datës 17.03.2026, ZPP ka pranuar për shqyrtim meritore dhe ka aprovuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE EJONA SHPK, duke e kthyer lëndën në rivlerësim pa bazë kontestuese, pa ndonjë ndryshim të rrethanave faktike apo juridike dhe në kundërshtim me vendimet detyruese të OSHP-së, me të vetmin qëllim ndryshimin e epilogut të konstatuar me vendimin e datës 06.03.2026. Vendimet e OSHP-së nr. 2025/0850, datë 27.10.2025, dhe nr. 2025/1239, datë 05.02.2026, si vendime të formës së prerë dhe detyruese për AK-në, të pakundërshtuara në gjykatën kompetente as nga AK-ja as nga OE EJONA SHPK kanë konstatuar se oferta e parashtruesit i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderit, ndërsa oferta e OE EJONA SHPK është e papërgjegjshme dhe duhet refuzuar.

Gjetjet e këtyre vendimeve janë materializuar në vendimin e datës 06.03.2026, me të cilin GOE Avag Group & H&S Partners Group Sh.p.k. shpallet fitues për LOT II, duke konfirmuar përmbushjen e të gjitha kriterëve të dosjes së tenderit, ndërsa oferta e OE EJONA SHPK eliminohet si e papërgjegjshme, bazuar në mosvazhdimin e afatit të validitetit të tenderit sipas kërkesës së AK (B47) dhe nenit 30.6 të RRPP, si dhe mospërmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes sipas dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP dhe nenit 40.6 të RRPP.

Megjithatë, vetëm 11 ditë më pas, i njëjti ZPP nxjerr vendimin e datës 17.03.2026, me të cilin e kthen lëndën në rivlerësim duke aprovuar kërkesën e OE EJONA SHPK, operator i cili nuk gëzon legjitimitet procedural dhe në asnjë rrethanë nuk mund të njihet si palë e dëmtuar apo fitues i mundshëm i këtij tenderi. Ky vendim, në kundërshtim të plotë me dispozitat relevante të LPP dhe RRPP dhe me vendimet detyruese të OSHP-së, ka shërbyer si pretekst për të ndryshuar rezultatin e vendimit të datës 06.03.2026 dhe për të arritur tek tendenca tashmë faktike e AK, anulimin e aktivitetit, me qëllim të vetëm parandalimin e nënshkrimit të kontratës me parashtruesin si fitues legjitim.

Siç përcaktohet me dispozitat e nenit 4.1.26 lidhur me nenin 103 të LPP-së, nenit 60, paragrafi 3, pika (e) të RRPP-së dhe Informimit Publik të datës 02.02.2023 të OSHP-së, një operator ekonomik i shpallur i papërgjegjshëm nuk mund të kualifikohet si palë me interes material dhe nuk ka legjitimitet për të paraqitur kërkesë për rishqyrtim, kërkesa të tilla duhet të hidhen poshtë si të palejuara. Statusi i papërgjegjshmërisë së OE EJONA SHPK është konstatuar nga vetë ZPP dhe konfirmuar me dy vendime detyruese të OSHP-së. Duke pranuar kërkesën e saj, ZPP ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me praktikën e vet juridike dhe me legjislacionin e prokurimit në fuqi.

Së dyti, pretendimet e aprovuara nga ZPP janë identike me ato nga letrat standarde të datave 27.11.2025 dhe 09.12.2025, ë shqyrtuara dhe refuzuara si të pabazuara nga OSHP-ja me vendimet detyruese nr. 2025:0850 dhe nr. 2025:1239, vendime të formës së prerë të cilat nuk janë kontestuar në gjykatën kompetente as nga AK-ja, as nga OE EJONA SHPK. Rihapja në këte faze e çështjeve të zgjithura me vendime të formës së prerë, dhe në mungesë të çdo baze kontestuese ligjore, përbën shkelle të parimit res judicata dhe të fuqisë detyruese të vendimeve të OSHP-së, në kundërshtim me nenin 4.1.26 lidhur me nenin 105, paragrafi 2.16 të LPP-së.

Së treti, aprovimi nga ZPP i pretendimit lidhur me vlerën e sigurimit të tenderit, me arsyetimin se kjo vlerë duhet të kishte qenë $2 \times 7,000 = 14,000$ euro duke e trajtuar kërkesën si kumulative për të gjitha lotet ku ka aplikuar operatori, është i pabazuar. Ky interpretim paraqet pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon me kriterin e dosjes së tenderit, e cila e ka strukturuar shprehimisht sigurimin si vlerë të pavarur për secilin lot 7,000 euro për LOT II, dhe jo si shumë kumulative, duke ngritur supozime të pabazuara me qëllim që të jepet përshtypja se diçka e paligjshme paska ndodhur nga ana e parashtruesit.

Sipas Udhëzuesit të Prokurimit Publik, kur AK kufizon numrin e loteve që shpërblehen tek një operator ekonomik, kërkesat minimale llogariten sipas vlerës më të lartë ndër lotet ku konkurron operatori, jo kumulative. Në rastin konkret, parashtruesi ka konkurruar në dy lote me vlerë të barabartë sigurimi dhe ka dorëzuar sigurimin e tenderit në shumën prej 7,000 euro saktësisht vlera e përcaktuar nga dosja për LOT II, për të cilin është shpallur fitues me Vendimin e datës 06.03.2026. Kërkesa e dosjes është përmbushur plotësisht dhe në mënyrë të ligjshme. Ndërsa sa i përket referencës të OE EJONA SHPK të vendimi i OSHP-së nr. 1033/2025, i lidhur me procedurë tjetër prokurimi dhe rrethana të ndryshme, nuk ka fuqi detyruese në rastin konkret dhe nuk mund të zëvendësojë zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave relevante të dosjes dhe të legjislacionit në fuqi.

Andaj, aprovimi i këtij pretendimi, i bazuar në keqinterpretim të qëllimshëm të dosjes së tenderit dhe të legjislacionit të prokurimit, përbën veprim të pabazuar me pretekst për t'i hapur rrugë anulimit të aktivitetit, ashtu siç ka ndodhur.

Për këto arsye, me anë të kësaj kërkesë, i drejtohem institucionit tuaj me qëllim që të ndalet këtu kjo paligjshmëri e qëllimshme dhe të anulohet vendimi në fjalë, në mënyrë që të garantohet e drejta e parashtruesit vetëm mbi bazën ligjore, në përputhje me vendimin e juaj të datës 06.04.2026, dy vendimet përfundimtare të OSHP, si dhe në përputhje me dispozitat relevante të LPP, RRPP, UPP dhe kufijtë e përcaktuar ligjor sipas Kodit Etik për të cilat jeni deklaruar nën betim.

3. Përfundim me propozime

Andaj duke marrë parasysh të gjitha arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lart, GOE ankues i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, administrimit të shkresave të lëndës dhe provave në shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenin 104, 105 dhe 107 dhe 117 të LPP-së, të merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET E BAZUAR** në tërësi Ankesa e parashtruar nga nga Grupi i OE-ve AVAG GROUP SH.P.K. & H&S Partners Group Sh.p.k.
2. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK (B58), i datës 16.04.2026, me të cilin MPB ka anuluar aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare – LOT II" në kundërshtim me nenin 62 te LPP dhe nenin 43 te RRPPvendimet detyruese të OSHP-së nr. 2025/0850 dhe 2025/1239.
3. **ANULOHET dhe SHFUQIZOHET** Aktvendimi i ZPP-së i datës 17.03.2026, me të cilin është pranuar e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE EJONA SHPK dhe është kthyer lenda në rivlerësim.
4. **OBLIGOHET** AK - MPB të vazhdojë menjherë me procedurën ligjore të nënshkrimit të kontratës me fituesin legjitim GOE AVAG GROUP SH.P.K. & H&S Partners Group Sh.p.k.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Obligimit të kompenzimit të shpenzimeve procedurale, kompenzimit të dëmit, dhe fitimit të humbur që do kërkohej pastaj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura *Në mbështetje të ankesës bashkëngjitet të gjitha provat e cekura.*

1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: **Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - II**

Nr. i Prokurimit ²	214-25-4909-2-1-1
-------------------------------	-------------------

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera e ofertës
	Llot - II Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare	Llot - II
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rruga Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, , 10000 Prishtinë, 10000, Prishtinë	239,400.00€
2.	" EJONA " SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja	214,444.80 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme shpërbën me kontratë, tenderuesit, Llot - II Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot II si me poshtë:

Për Llot - II Grup i Operatorëve Ekonomik AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rruga Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, , 10000 Prishtinë, 10000, Prishtinë në vlerë totale të ofertës, prej 239,400.00€

Data: 06/03/2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI

¹ Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.



Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm

Prishtinë: 06.03.2026

Autoriteti Kontraktues: MPB – Divizioni i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: Grup i Operatorëve Ekonomik AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rruga Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, , 10000 Prishtinë, 10000, Prishtinë

Nr. i Prokurimit

214-25-4909-2-1-1

Titulli: Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI

Për Llot - II Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare

I/e nderuar(a) [Z/Znj] _____]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin për Lot II në vlerë prej 239,400.00€ në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadim të intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]



Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Prishtinë: 06.03.2026

Autoriteti Kontraktues: MPB – Divizioni i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " EJONA " SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja

Nr. i Prokurimit

214-25-4909-2-1-1

Titulli: Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI

Për Llot - II Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare

I/e nderuar(a) _____

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Nenin 59. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është Administrativisht i pa përgjegjshëm nuk keni dorëzuar:

Nuk ka vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit për Lot II sipas kërkesës administrative të AK-së nuk ka respektuar afatin kohor të AK-së, të përcaktuara në B47 - Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 10.10.2025.

Dorëzimi i vazhdimit, duhet të dorëzohet nga ana e Juaj në adresën elektronike përmes platformës së E-prokurimit (Dorëzimi i dokumenteve në AK), më së largu deri më 15.10.2025, në të kundërtën tenderi juaj do të refuzohet.

Ndërsa ju keni dorëzuar vazhdimin me datën 16.10.2025 shih dëshminë e sistemi.

Dërguar nga : " EJONA " SH.P.K.	16.10.2025 09:09
Dokumenti për dërgim të AK 20251016093627451.pdf	16.10.2025 09:00
Hape: <input type="button" value="Shqip"/>	

pra jeni përgjigjur me vonës . ketë e konstaton edhe Vendimi i OSHP: nr. 2025/1239.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Komisioni i ri-vlerësimit , pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatorit Ekonomik, konstatoi këto mospërputhje me kërkesat e dosjes së tenderit: duke u mbështetur ne vendimet e OSHP: nr. 2025/0850 dhe OSHP: nr. 2025/1239 të cilat ju kanë konstatuar si OE të pa përgjegjshëm.

Mbështetur në arsyetimin e cekur më lartë, tenderi-oferta Juaj është REFUZUAR dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtuqjshëm.

Ju informojmë së kontrata i është dhënë OE-së Grup i Operatorëve Ekonomik AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rruga Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, , 10000 Prishtinë, 10000, Prishtinë në vlerë totale të ofertës prej 239,400.00€

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtronit ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të punojmë me kompaninë tuaj kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrim]



①

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË- SHËRBIM
Nr. i Kontratës 214-25-4909-2-1-1/C611

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Operatori Ekonomik LURN SH.P.K., Rr Ibrahim Krasniqi nr.10, Prishtine, me nr. të ARBK-së 810084062 (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli: Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI me numër identifikues: 214-25-4909-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

<i>Nr.</i>	<i>Grupi</i>
6	Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Llot – I

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të dy palëve dhe përfundon **max. 36 muaj**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **i menjëhershëm** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **Ndërtesat Qeveritare sipas Aneksit 1 të DT-së**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës Për **Lot- I** është **149,040.00€** (*Njëqind e katër-dhjet e nëntë mijë e zero katër-dhjet e 00/100 euro*). Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë së plus/minus tridhjetë përqind (30%) nga vlera totale e kontratës.

Lot- I Oferta financiarë e datës 15/07/2025 bashkëngjitur në formë të shtojcës kësaj kontrate

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); 15/07/2025
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët 3 në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri e mbiemri :	Agim ISLAMI
Pozita:	U.D Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	10/02/2026
Vula:	

Në rast te kontratave me vlere te madhe

Emri e mbiemri :	z. Genc METAJ	Emri e mbiemri :	z. Xhelal SVEÇLA
Pozita:	Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së	Pozita:	Ministër i MPB-së
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.03.2026	Data:	12.03.2026
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri e mbiemri :	Beut Hasony
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	13/03/2026
Vula:	



PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department for Procurement

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve

Sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data

15.05.2025

E rezervuar për AQP

Data e pranimit ___/___/___

Nr. i Prokurimit:

--	--	--	--	--	--

Identifikuesi _____

NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK	Ministria e Punëve të Brendshme	Personi kontaktues e-mail	"[shëno email-in e personit kontaktues të AK]"
Adresa	Rr "Luan Haradinaj"- p/n ndërtesa qendrore e MPB-së	Kodi postar	10 000
Qyteti	Prishtinë	Regjioni	Prishtinë
Telefoni		Faksi	
e-mail		URL:	

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1. VLERËSIMI I NEVOJAVE

II.1.1 Klasifikimi (FPP):

--

II.1.2 Natyra dhe fushëveprimi:

"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare-Lot1, Lot2, Lot3, Lot4 ,Lot5, Lot6"

II.1.3 Vlera e parashikuar për 36 muaj

TOTAL 1,320,000.00 euro

II.1.4 Kushtet Materiale: Lënda e kësaj kontrate është:
+5

II.1.5 Specifikacionet funksionale, përfitimet dhe kostot:
Referoju Aneksit I të bashkangjitur.

II.1.6 Planifikimi:



A ka qenë ky aktivitet i prokurimit i përfshirë në parashikimin e prokurimit?

Po


Jo

Nëse jo, deklaro arsyen pse nuk ka qenë i përfshirë

II.1.7 Deklarata lidhur me atë se si ky prokurim do të promovojë objektivat institucionale të autoriteteve kontraktuese:

Qëllimi kryesor i këtij prokurimi është:

Me realizimin e këtij projekti do të realizohen shërbimet në mirëmbajtje teknike për ndërtesa qeveritare

Departamenti kërkues:	DSPIMNQ
Zyrtari kërkues:	Flurije DURMISHI
Data:	16.05.25
Nënshkrimi i personit kërkues	

II.2 DISPONUSHMËRIA E FONDEVE

II.2.1 Deklarata mbi disponueshmërinë e fondeve:

Zyrtari Kryesor Financiar "ZKF" duhet formalisht të sigurojë që fondet janë të disponueshme për prokurimin në fjalë. *[në rast të një autoriteti publik apo një organizate buxhetore]*

Zyrtari Kryesor Financiar "ZKF" duhet formalisht të sigurojë që janë përvetësuar mjetet për prokurimin në fjalë në një shumë të mjaftueshme për të përmbushur obligimet financiare që mund të rrjedhin gjatë periudhës së vitit të tanishëm fiskal si rezultat i këtij prokurimi.


A është ky projekt shumë-vjeçar?

Po

Jo


II.2.2 Deklarata e mos-disponueshmërisë nga ndonjë autoritet tjetër publik (nëse AK është një Autoritet publik apo një organizate buxhetore):

[Deklarata]

Zyrtari Kryesor Financiar:	Drita XHELADINI
Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesor Financiar:	
Data e aprovimit nga ZKF:	20/07/25

II.2.3 Aprovimi:

Për aktivitetin e prokurimit në fjalë të shfaqur në këtë formularë, Zyrtari Kryesor Administrativ njofton se kërkesat e nenit 9.1-9.4 të LPP-së janë në përmbushur nga Autoriteti Kontraktues dhe jep pajtimin e tij/saj për iniciimin e aktivitetit të prokurimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ:	Fahrije TËRNAVA SHEREMETI
Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesor Administrativ:	
Data e aprovimit nga ZKA:	21/05/2025



Të plotësohet pas dhënies së kontratës dhe para nënshkrimit të kontratës

NENI 3: SHQYRTIMI

Kjo "Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve" duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para nënshkrimit të kontratës me tenderuesin fitues me qëllim që të rikonfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht.

Ndryshimet: Po Jo

Nëse po, tregoni referencat e paragrafëve dhe informacionet e modifikuara

§	
§	

Nr. i dokumentit të Urdhëresës së Zotimit dhe Pagesës (UZP) [shëno nr. UZP]

Kopja e dokumentit të UZP duhet të bashkëngjitet

Nënshkrimet:

Zyrtari i Prokurimit:	Emri: Agim ISLAMI	 Nënshkrimi	Data: <u>13/08/2025</u>
Zyrtari Kryesor Financiar:	Emri: Drita XHELADINI	 Nënshkrimi	Data: <u>13/08/2025</u>
Zyrtari Kryesor Administrative:	Emri: Fahrije TËRNAVA SHEREMETI	 Nënshkrimi	Data: <u>13/08/2025</u>



Buxheti i Kosovës për vitin 2026

Tabela 3.2 Projektet Kapitale për Nivelin Qendror

Organizata Buxhetore - Programi - Nën-Programi				Aprovuar per vitin 2026				Vlerësuara për			Vlera Totale		
Kodi Funk	Kodi i Prop	Kodi Proj	Data e Fillimit dhe Mbarimit	Emri i Projektit	Burimet E Fin.	Shpenz der më 2025	Vazhdim nga 2025	Të reja për 2026	Totali 2026	Vitin 2027	Vitin 2028	Vitin >2029	Projektit
0133	214385-2035551	18551	01.2022-12.2027	Ndërtimi i Objektivit të Mensës për vijues të ASP në AKSP	GQ	789,769	617,285	0	617,285	200,000	200,000	0	1,807,054
0412	214385-2341295	19098	01.2025-12.2028	Furnizim me Makina të Lavandaris	GQ	87,990	0	0	0	50,000	50,000	0	187,990
0133	214385-2647542	20624	01.2027-12.2028	FURNIZIM ME REZERVUARË TË UJIT	GQ	0	0	0	0	50,000	50,000	0	100,000
				Totali (GQ) - Akademia e Kosovës s për Siguri Publike		1,437,450	817,285	0	817,285	817,285	817,285	0	3,889,305
				Totali - Akademia e Kosovës s për Siguri Publike		1,437,450	817,285	0	817,285	817,285	817,285	0	3,889,305
				Totali (GQ) - Akademia e Kosovës për Siguri Publike		1,437,450	817,285	0	817,285	817,285	817,285	0	3,889,305
				Totali - Akademia e Kosovës për Siguri Publike		1,437,450	817,285	0	817,285	817,285	817,285	0	3,889,305
214391 - Dep.Standarteve dhe Politikave të IMNQ-së													
12300 - Departamenti i Standardave Dhe Politikave te IMNQ													
0111	101002-1730166	15057	02.2018-12.2028	Projekti Blinaja	GQ	86,395	1,000,000	0	1,000,000	2,643,750	3,843,750	0	7,573,895
0133	202037-093546	10012	06.2022-12.2028	Kompleksi I Ri Qeveritar, ne Hajvali ne afersi te Prishtines	GQ	4,200,503	2,201,500	0	2,201,500	2,100,000	3,200,000	0	11,702,003
0133	202037-106853	12061	01.2010-12.2028	Kompleksi Rilindja- Vlersimi i Kompleksit Rilindja dhe Renovimi i Anekseve B,C dhe D	GQ	4,726,203	1,500,000	0	1,500,000	3,035,750	3,035,750	0	12,297,703
0133	202037-1214207	12992	01.2012-12.2028	Renovimi i Objekteve Qeveritare	GQ	11,494,028	2,990,000	0	2,990,000	3,781,096	3,781,096	0	22,046,220
0360	202037-1317621	13437	01.2013-12.2028	Ndërtimi i ndërtesave perçjellese te ndertesese se AKI	GQ	14,816,672	1,500,000	0	1,500,000	1,500,000	1,914,250	0	19,730,922
0474	202037-1832754	15715	03.2018-12.2028	Ndërtimi i Nderteses per Zyren e Presidencës	GQ	100,000	10,000	0	10,000	10,000	10,000	0	130,000